

rastin e 100-vjetorit të lindjes së Asdrenit

ÇO BIHIKU

ASDRENI — POET DHE KOHA E TIJ *)

Ka kaluar një shekull që nga lindja e Asdrenit dhe 25 vjet nga dekjia e tij. Ai rrojti plot 75 vjet. Një jetë kjo e gjatë që përfshiu disa nga etapat kryesore të jetës historike të popullit shqiptar në shekullin XX.

E gjithë veprimtaria krijuese e Asdrenit është e lidhur me luftën e tij për çlirimin e atdheut nga zgjedha turke, dhe për një të ardhme më të lumtur e më të ndritur të vendit. Në krijimet e veta Asdreni i këndoi me frymëzim të zjarrtë dashurisë për atdheun, tregoi shpirtin e lartë patriotik të masave të popullit. Bir i vegjëlisë, demokrat nga pozita shoqërore dhe bindjet e tij, Asdreni ëndërroi dhe luftoi me synimin e madh për ngritjen e një Shqipërie të popullit të thjeshtë, të «opingës» dhe i mbeti besnik këtij ideali deri në fund të jetës së vet. Pjesa më e rëndësishme e krijimtarisë së poetit afirmoi nevojën e një organizimi më të drejtë të shoqërisë dhe shprehu synimet e vegjëlisë për barazi dhe drejtësi shoqërore.

Neveria ndaj moralit borgjez, aspirata për një shoqëri ku të sundojë harmonia e mirëkuptimi, përbën një nga tiparet e veprës së Asdrenit. Në një sërë krijimesh të tij, ai zbuloi gjendjen e vështirë të njeriut të ndershëm në rendin borgjez, ku objektivi i çdo veprimtarie është paraja.

Asdreni është një nga autorët më të ndërlikuar të historisë së lehtësisë shqiptare. Duke u përpjekur sot të përvijojmë në vija të trasha tiparet themelore të personalitetit të Asdrenit si poet, nuk mund të harrojmë se pjesa më e madhe e jetës dhe e veprimtarisë së tij koïncidoi me kohën kur lëvizjes demokratike shqiptare i qëlloi të përballojë prova të rënda; ishte kjo kohë diluzionesh të hidhura për shumicën e patriotëve dhe të demokratëve shqiptarë, të cilët panë se gjaku i derdhur nga sa e sa breza nuk solli realizimin e ëndërrës së tyre për një Shqipëri të lirë. Me këtë shpjegohet fakti pse krahas frymës demokratike, në krijimtarinë e Asdrenit, vihet re paqartësi në të kuptuarit e tendencave të zhvillimit të mëtejshëm të njerëzimit dhe pse, me gjithë qëndrimin kritik ndaj marrëdhënjeve sunduese në shoqëri, poeti nuk arriti të shohë atë forcë reale sociale, e cila do të vinte në jetë programin e tij pozitiv. Të gjitha këto përcaktuan frymën e pesimizmit dhe të lodhjes, që vihet re në një varg krijimesh të tij të viteve 20 e 30.

*) Në themel të këtij artikulli është fjala e mbajtur në mbrëmjen përkujtime më organizuar në Tiranë më 17 prill 1972, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit.

* * *

Brezi që nisi jetën e vet të ndërgjegjshme në vitet 20 dhe 30 dhe brezi që kjo kohë e gjeti në bangat e shkollës, me librat e këndimit përpara, kur kujtojnë Asdrenin, sjellin ndër mënd vjershën e njohur «Betimi mbi flamur», që shërbeu si tekst i hymnit kombëtar. Në kujtesën e këtyre brezave rijehojnë me embëlsinë e rrjedhshmërinë karakteristike vargjet e poetit drenovar, ku i këndohej bukurive të Shqipërisë, ato vargje të thjeshta për stinat e motit, që ngjallnin në shpirt dashurinë për natyrën e vendit dhe gjuhën amtare.

Fakti se Asdreni hyri në vetëdijen e bashkëkohësve dhe të brezave që erdhën më pas si këngëtar i atdheut, si poeti që nxiti tek njerëzit ndjenjat atdhetare, gjen shpjegimin e vet në brendinë dhe karakterin e një pjese të mirë të krijimtarisë së tij poetike.

Asdreni hyri në letërsi në fillim të shekullit XX. Që në fund të shekullit të kaluar lufta e popullit shqiptar për çlirim nga Turqia kishte marrë karakter të gjerë dhe të organizuar. Rrethe dhe shtresa të reja të popullit po zgjoheshin dhe po mirrnin pjesë aktive në radhët e lëvizjes. Veç shoqërisë patriotike të Bukureshtit dhe të Egjyptit, më 1893 në Sofje ngrihet shoqëria «Dëshira», me një shtypshkronjë e cila do të nisë të botojë libra dhe të përkohshme shqipe. Më vonë u ndez edhe tek shqiptarët e Amerikës një vatër tjetër patriotike, e cila do të luante një rol jo të vogël në lëvizjen e të gjithë shqiptarëve për çlirimin kombëtar. Për zgjerimin dhe forcimin e lëvizjes në këtë kohë flet edhe shtimi i gazetave dhe i revistave patriotike, të cilat në këtë kohë kishin arritur afro në 30. Duke kuptuar se pa një zgjim më të madh të ndërgjegjes kombëtare nuk mund të arrihej organizimi i të gjithë shqiptarëve në luftë për çlirimin e vendit, shoqëritë dhe organet patriotike kishin bërë një punë të gjerë për të përhapur idenë e luftës për fitimin e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare.

Në fillim të shekullit XX përpara patriotëve shqiptarë u shtrua detyra për të kaluar nga puna propaganduese e sqaruese në atë të organizimit të forcave për mësymjen e fundit kundër zgjedhës otomane. Këtë e kërkonte jo vetëm pjekuria që kishte fituar lëvizja, por edhe rrethanat e jashtme politike. Ngjarjet në Ballkan po rrokulliseshin me shpejtësi të madhe. Perandoria otomane, si rezultat i dekompozimit të brendshëm gradual nga njëra anë dhe i valës së fuqishme të rezistencës së popujve të shtypur nga ana tjetër, po lëkundej nga themelet dhe pritej me sot e me nesër që të shëmbej përdhe. Ishte pra një kohë që zjente nga ngjarjet, kohë për veprime energjike dhe të vendosura.

Në këtë atmosferë politiko-shoqërore u formua botëkuptimi i Asdrenit dhe u zhvillua puna e tij krijuese poetike. Ai përvetësoi idetë e lëvizjes së përgjithshme për çlirim nga pushtimi otoman, u frymëzua nga përpjekjet e patriotëve për t'u kallur në shpirt bashkëatdhetarëve ndjenjën e vetëdijës kombëtare, për t'i nxitur ata që të bashkohen dhe të organizohen për fitimin e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare.

Sapo erdhi në Bukuresht në vitin 1899, Asdreni u përfshi në lëvizjen për çlirimin kombëtar, i mbushur plot ndjenja të flakta atdhetarie dhe me synimin e lartë për t'i kushtuar çështjes së lëvizjes talentin dhe jetën e vet. Gatishmëria për t'i shërbyer me vetmohim Shqipërisë, për të bërë gjithshka për çlirimin dhe zhvillimin e vendit në rrugën e përparimit shoqëror dhe kultural, u bë impulsi kryesor i Asdrenit gjatë gjithë

jetës së tij. Qëllimi dhe brendia e jetës së tij u bë çështja kombëtare. Ata që e njohën së afërmi dëshmojnë se Asdreni ishte patriot i ndershëm dhe i sinqertë, që e deshi Shqipërinë me të gjitha fijet e zemrës së tij dhe ëndërroi një të ardhme të ndritur për popullin shqiptar.

Krijimet e tij të para poetike si «Mallkimi», «Pall' e Skënderbeut», «Poshtë errësira», «Ardhi dita», «Flamuri kombëtar», që panë dritë në revistën «Albania», tërhoqën vëmëndjen e patriotëve për ndjenjën e flaktë patriotike, për shqetësimin e sinqertë të autorit që mjaft shqiptarë ende s'ishin çpërgjukur, për dëshirën e tij që çështja kombëtare të ecë me hapa sa më të shpejta.

Ashtu si Naimi e poetë të tjerë të kohës, Asdreni nuk pushon së foluri për bukuritë e paçmuara të natyrës shqiptare:

*Shih sa vent plot bukuri,
ku del ar, ku del flori,
ku ndrit djelli me shkëlqim
dhe qesh hëna me pëlqim,
si në vend të përrallave,
trimave dhe pallave.*

Gjejmë në këto vargje atë përgjërimit që kishin rilindasit për vendin, për natyrën e atdheut, përgjërimit, që i çoi ndonjëherë në emër të çështjes së edukimit patriotik, në atë idilizim, që u jep poezive të tyre atë lirizëm të butë karakteristik.

Poeti u kujton shqiptarëve mjerimin në të cilin ndodhej atdheu nën thundrën e të huajit; ai nuk nguron ta përshkruaj, me një realizëm të guximshëm gjëndjen. Asdreni qahet jo vetëm për gjëndjen e poshtëruar, ku dergjej atdheu, por përpiqet të zbulojë edhe shkaqet që kanë përcaktuar këtë gjëndje. Me gjithë luftën e madhe që bënë rilindasit kundër propagandës së huaj, prap ajo vijonte të pengojë shumë shqiptarë, që të shikonin se në ç'anë qëndrojnë interesat kombëtare të vendit. Kësaj i duhet shtuar edhe puna përçarëse e klerikëve antipatriotë dhe, në përgjithësi, e forcave konservatore e anadollake, që s'linin gjë pa bërë për të penguar lëvizjen kombëtare. Kundër të huajve dhe veglave të tyre drejtoheshin plot zemratë këto vargje të poetit:

*Më njanë fetë, besët edhe tradhësia.
Më njanë gjaku edhe harbutësia!
Poshtë errësira, poshtë edhe robëria
Rroftë bashkimi, rroftë vëllazëria.*

Synimi i Asdrenit në poezitë e veta ishte të zgjonte shqiptarët nga letargjia e shekujve të robërisë otomane, t'i nxiste ata që t'i viheshin punës në dobi të çështjes së çlirimit të vendit. Asdreni nuk nguron t'i kritikojë ashpër bashkëatdhetarët, t'i prekë ata në sedër dhe t'i qortojë, që e lënë veten të mashtrohen prej propagandës armike.

*S'u ngoptë edhe me të rremta
si armiqtë nuk i shihni*

— shpërthen poeti me mllef.

Poeti u kujton shqiptarëve përgjegjësinë që kishte vënë historia mbi shpatullat e tyre. Çështja kombëtare do të fitojë me veprime energjike

dhe të guximshme. As çasti historik dhe as brezat e ardhshme nuk do t'ua falin shqiptarëve plogështinë dhe ngathtësinë që po tregojnë:

*Burrani o shqipëtarë
trima burra luftëtarë
mos u lini, mos duroni
kështu jetën ju ta shkoni
tërë bota të na qeshin
të na hanë, të na çveshin.*

*Por e merrni punën mbarë
mos e hiqni kështu zvarë
se një ditë do të vijë
dhe kushdo munt që ta dijë
kur përpara Zotit tonë
si të moçmit që na thonë
fjalë kemi për t'i dhënë
gjyqit lartë që ka vënë,
ne të zotrit në mos qofshim
punën tonë mos mbarofshim.*

Ka disa vjersha («Dëshirë», «Mjaft», «Pyetje e përgjigje», «Lutja e të humburve») ku poeti na shfaqet pesimist. Atij i duket se përpjekjet e patriotëve po venë kot dhe nis e shikon zi në të ardhmen e Shqipërisë. Por kjo ishte e përkohshme, kalimtare në frymëzimin e Asdrenit. Ndjenja e dëshpërimit kthehet tek ai në kushtrim, që zgjon nga gjumi dhe thërret për luftë bashkëatdhetarët. Optimizmi, bindja në drejtësinë e çështjes kombëtare, besimi në patriotizmin e shqiptarëve, formojnë notën mbizotëruese të lirikës patriotike të Asdrenit. Kemi parasysh vjershën «Besa jonë»:

*Atje sipër e ka shkrojtur;
Dor' e Zotit që urdhëron
se ne kemi për të rrojtur
kombi ynë s'perëndon*

ose vjershën «Varrit të Skënderbeut», e cila ushton nga besimi në të ardhmen e Shqipërisë:

*Se kurrë kombi shqiptar
rob tjetrit s'i është për t'u bërë
po do të luftojë për një dhé
ku i madh çlodhet Skënderbe.*

Pra, Asdreni u përpoq me fjalën e vet artistike të ndezë zemrat e shqiptarëve, t'i çojë ato peshë në luftën për idealin e shënjtë të çlirimit dhe të lulëzimit të Shqipërisë.

Por kjo karakteristikë për Asdrenin nuk është e plotë. Ajo që përbën thelbin e frymëzimit të tij, atë element specifik që e dallon nga poetët e mëparshëm, është fryma demokratike. Në krijimtarinë e Asdrenit gjeti pasqyrim etapa e re e lëvizjes çlirimtare të popullit shqiptar kur në rreshtat e saj vjen një radhë e tërë intelektualësh të të një formacioni të ri, me frymë e pikëpamje demokratike revolucionare, të cilët kishin dalë nga gjiri i masave të popullit dhe i shikonin këto, si të vetmen forcë për çlirimin e vendit. Intelektualët demo-

kratë u përpoqën t'i japin lëvizjes karakter revolucionar, duke e lidhur çështjen e çlirimit kombëtar me çështjen e çlirimit të fshatarësisë dhe shkatërrimin e marëdhënjeve shoqërore anakronike mesjetare. Asdreni bënte pjesë në falangën e këtyre intelektualëve, që shprehën në veprimtarinë e tyre publicistike dhe letrare aspiratat e vegjëlisë për çlirim shoqëror.

Nga artikujt që nisi të botonte që në fillim të veprimtarisë së vet dhe nga letrat që na kanë mbetur prej tij, del se Asdreni, që kur hyri në lëvizje, kishte pikëpamje politiko-shoqërore të formuara në vija kryesore. Ai na çfaqet si patriot konsekuent, mbrojtës i flaktë i interesave të vegjëlisë, armik i shtypjes despotike të bejlerëve për krijimin e një Shqipërie, ku masat e popullit të mos merren nëpër këmbë nga klasat e larta. "Në është që ca duan të marrin mprimin e oxhakësisë-shkruante ai më 1902-aq më tepër ne duhet të marrim mprimin e vegjëlisë, se jo parësia është shtyll' e kombit, po vegjelia. Ajo vegjëli që derdhet kurdoherë më çdo rrezik, kur parësia rri e vështrohet për së largu, ajo vegjëli që është përpjekur edhe sot përpiqet me nevojat e rënda, të cilat nevoja parësia nuk i ndjen se lëpin këmbët e anadollakëve për ca ergjënt.

... Është detyra jonë të mos e lëmë vegjëlinë në thonjtë e mprehta të parësisë, po të kërkojmë t'i shërojmë plagët e gjakta, të dhëmburit e të cilëve e ndjen gjer në palcë".

Para çlirimit pati përpjekje për ta paraqitur Asdrenin vetëm si autor lirikash atdhetare, duke injoruar brendinë demokratike të veprës së tij. Citati që sollëm më sipër dhe një sërë krijimesh të tij, dëshmojnë në mënyrë më se të qartë se sa të pathemelta ishin këto orvatje. Fati i popullit, gjëndja e tij nën sundimin e bejlerëve mizorë, të drejtat dhe interesat e tij, formonin shqetësimin kryesor të Asdrenit.

Poeti besonte se nuk do të vonojë koha e çlirimit të vegjëlisë; shpresën e tij për këtë të ardhme të bukur ai e shprehu në figurën e lulëkuqes, e cila ndez zemrat me ngjyrat e saj të zjarrta.

*Ajo ngjyrë kur zë e çfaqet,
mbreti fronë shkon e le,
njerëz robër fare s'sheh,
vjen e drejta del në faqet
si zot je.*

Vërtet, këtu nuk tregohet konkretisht se si do të ngjasë kjo, por megjithatë në formën e simbolit romantik është shprehur hapur dëshira dhe parandjenja e ndryshimeve të thella shoqërore.

Asdreni pasqyroi konfliktin midis luftëtarëve të lirisë që vinin nga gjiri i vegjëlisë dhe parisë tradhëtare, bejlerëve dhe borgjezisë konservatore. Në një varg krijimesh të tij, ai zbuloi lakuriq fytyrën morale të këtyre klasave, të cilat në ato çaste vendimtare që kalonte Shqipëria e bënë veshin të shurdhër ndaj thirrjes së saj. Antipatriotizmi i përfaqësuesve të parësisë s'është tjetër veçse shprehje e egoizmit të tyre si klasë;

*Ju s'keni as shpirt, as zemër, dhëmbje ndjeni
Përpara jush kur krah' e duar ndehen*

*... Sa lot nuk janë derdhur pa shterruar
Shtëpi sa s'kanë mbetur sot të shkreta,
Sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar*

Duke stigmatizuar me ashpërsi qëndrimin antipatriotik të parësisë Asdreni kërkon që ata të pushojnë veprimet e tyre tradhëtare, në qoftë se nuk duan të përplasen mbi kokën e tyre hakmarrja popullore. Në poezinë «Zëri i kryengritësve» afirmohet ideja se shtylla e lëvizjes kombëtare është vegjëlja; në antitezë me jetën luksoze e plot të mira të klasave të pasura, me egoizmin, ligësinë dhe çthurjen e tyre, kemi patriotizmin, vetmohimin dhe shpirtin liridashës të vegjëlisë.

*Ne derdhim gjakun lumë, ju veç pasje
ne vdekje tmerr presim, ju veç rojtje.*

Të pasurit nuk kanë tjetër ideal veç arit; atdheu për ta ishte vetëm një fjalë boshe, Këtë ide që përshkon krijimet e mësipërme, Asdreni do ta përsërisë edhe në vjershën "Çpërblimi", në të cilën tregohet historia e një luftëtari patriot, që dha gjithshka për çështjen e çlirimit të atdheut dhe mori për këtë shpërblim mosmirënjohjen e parësisë egoiste e lakmimitare. Vjersha ndërtohet mbi antitezën e gjëndjes tragjike të luftëtarit të lirisë dhe të jetës së mbushur me gëzime e qejfe luksoze të të pasurve. Atë e përshkon urrejtja e mallkimi ndaj parësisë që jo vetëm iu rresht detyrës së tij patriotike, por ja shpërbleu vegjëlisë sakrificat e përpjekjet me përbuzje dhe tallje. Por të pasurit s'kanë pse të gëzohen, thërret poeti, gazi i tyre mund të kthehet në helm, sepse kupa e durimit të popullit po mbushet.

Lirikat politiko-shoqërore zënë një vënd të rëndësishëm në krijimtarinë e Asdrenit; pikërisht në këto krijime ai u shfaq si poet i shqetsimeve dhe aspiratave të vegjëlisë. Po në qoftë se marrim të tërë veprën e tij, do të shohim se këto lirika shënojnë një dukuri fare të re në poezinë shqiptare, jo vetëm në pikëpamje të motiveve, por edhe artistike. Duke vazhduar arritjet e poetëve të mëparshëm, Asdreni dha kontribut të rëndësishëm në pasurimin e diapazonit të mjeteve të poezisë sonë. Ndryshe nga lirikat patriotike të Naimit dhe të Çajupit, të cilat kanë karakter kryesisht lirik, Asdreni priret nga përgjithësimet epike. Kjo shihet në strukturën e thurjes dhe të kompozicionit të lirikave të tij (karakterit i hapur funksional i pamjeve konkrete, veçoritë tipike të karakterit të personazheve dhe të situatave etj.). Poeti thekson tiparet «sociale» të heronjve të vet në atë masë që ata dalin në lirikat e tij, tregon se kush janë ata etj. Krahas kësaj poezia e tij bëhet më e pasur gjithashtu edhe nga pikëpamja e stilistikës dhe e ritmikës.

Kur flitet për Asdrenin si poet, që shprehu mendimet dhe aspiratat e vegjëlisë për drejtësi shoqërore, zakonisht u referohen vjershave «Lulekuqeja», «Zëri i kryengritësve», «Krerëve tradhëtarë» etj., në të cilat, siç e vumë re më sipër, gjetën pasqyrim tendencat dhe ndryshimet e reja që kishin nisur të shtillen në gjirin e lëvizjes çlirimtare të popullit shqiptar në fillim të këtij shekulli. Por Asdreni shkroi edhe shumë krijime poetike — dhe këto përbëjnë një numër të konsiderueshëm, — në të cilat pasqyroi ndjenjat edhe shqetësimet e njeriut të thjeshtë jo në kushtet e ndeshjes së ashpër e të drejtpërdrejtë me armiqtë e tij të klasës, por në rrethana të tjera, më të veçanta, përballë realitetit të egër të shoqërisë borgjeze. Prandaj po ta shfletojmë me kujdes veprën e Asdrenit, do të shohim se përkrah poetit patriot, që grish për luftë dhe stigmatizon me guxim klasat e larta, do të na shfaqet figura e një njeriut të ndershëm, që vuan moralisht tek sheh çoroditjen e shoqërisë që

vjen nga roli i madh i parasë, poshtërsitë që kryejnë njerëzit për të fituar pasuri.

Në krijimtarinë e Asdrenit që në krye u shfaq një nga veçoritë dalluese të frymëzimit të tij — deluzioni dhe pakënaqësia nga realiteti shoqëror, mungesa e besimit ndaj mundësisë së rregullimit më të mirë të shoqërisë, notat e pikëllimit dhe të pesimizimit, që shquajnë heroin lirik të vjershave të tij. Pa dyshim, ka disa shkaqe objektive të gjendjes tragjike në të cilën e ndjen veten poeti në mërgim. Djalë argati, që e la fshatin kur i kishte formuar tashmë konceptet dhe përfytyrimet e tij etiko-morale, Asdreni, me sa duket, nuk iu adaptua ligjeve shqiptare që rregullojnë shoqërinë kapitaliste. Kësaj i duhet shtuar fakti se, i dhënë tërësisht pas çështjes së lëvizjes, ai nuk rregulloi punët e tij vetjake dhe mbeti kështu deri në fund të jetës së vet njeri pa njeri. Jeta atij i kaloi në shtërngicë dhe gjithmonë me hallin e sigurimit të jetesës. Ai mbeti tërë jetën një intelektual i varfër, një proletar i punës mendore, që e nxori jetesën me punë jo të përhershme, duke qenë i varur shpesh nga mëshira dhe ndihma e të tjerëve.

Asdreni është ndër të pakët poetë shqiptarë, që pasqyroi me forcë emocionale artistike gjendjen tragjike e të pasigurtë të njeriut të thjeshtë në shoqërinë borgjeze. Në shumë vjersha të mbushura me pikëllim e trishtim, na shfaqet një shpirt i çiltër, që vuan thellë kur sheh përreth luftën pa skrupull për të fituar sa më shumë flori dhe mall. Atë e mundon çështja: pse njerëzit janë lakmimtarë dhe të pangopur, kur në botë ka kaq pasuri e të mira?

*Cili do t'jetë shkaku i vërtetë.
Që kurrë të mos jenë në pajtim.
Kur kjo botë ka, e mund të ketë
Për të gjithë sa rrojnë një qëllim?*

— pyet poeti veten me naivitet.

Por nuk mund të mos vihet re se në disa krijime, Asdreni, megjithëse në përgjithësi i mungonte një kuptim i qartë i ligjeve të zhvillimit të shoqërisë, e hetoi drejt shkaku të vërtetë të dizarmonisë dhe të mosmarrëveshjeve që karakterizojnë marrëdhënjet e njerëzve në shoqërinë me klasa. Është etja për para, për ta përdorur këtë si mjet sundimi mbi të tjerët, arsyeja që e shtyn, njeriun, siç thotë poeti, «të vrasë e të vjedhë pa turp».

Asdreni kishte besimin se përhapja e madhe që kishte marrë dituria, do të sjellë përsosjen morale të njerëzve, të cilët më në fund do të zhvishen e të pastrohen nga veset e tyre. Por ky ishte iluzion naiv i një iluministi, i cili nuk e kuptonte se babëzia, egoizmi dhe lakmia për pasuri janë inerente në sistemin e shoqërisë me klasa, ku njeriu është ujë për njeriun. Një nga vjershat më kuptimplote nga kjo pikëpamje «Çaste hidhërimi», na tregon fatin e poetit, plot aspirata fisnike në jetë, por i paaftë për të luftuar për realizimin e tyre dhe që përpëlitet i dëshpëruar pa ditur rrugëdalje nga dyshimet që e torturojnë:

*Hyj në dhomë fare ngrysur
burg më duket kur shoh muret,
Dhe me kryet të përmbysur:
Nis mejtimi të më çthurret.*

Duke mos i dhënë dot përgjigje pyetjeve që e mundojnë, për një hop, ai është gati ta hedhë këtë botë të padrejtë në greminë:

*Në atë orë, ças mërije
T'isha i zoti, i fuqisë
Do të mirrnja dheun ta shtije
Të gremiset tej n'abissë!*

Por ky është vetëm një çast, që kalon shpejt; ajo që mbetet është dëshpërimi i poetit, i cili e ndjen veten të pafuqishëm t'u japë përgjigje pyetjeve që e mundojnë. Asdreni e ndjente fort vetminë dhe tëhuajimin e vet në shoqërinë që rronte, pamundësinë për t'iu adaptuar moralit dhe ligjeve të saj.

I dëshpëruar nga atmosfera mbytëse që sundon në shoqërinë borgjeze, Asdreni kërkon të ikë fare nga bota reale.

*Të shkonja larg nga dheu, skëterra
Ta linja botën, njerëzit siç janë,*

*Si bishat e egra le të çirren
të tallesha së largu, atje mënjanë
Të shoh të rremat posht si vdiren.*

Në krijimtarinë e Asdrenit përsëritet antiteza: në qytet njerëzit janë prishur, aty janë zhdukur vlerat morale si miqësia, dashuria, shoqëria, etj. Kurse në fshat nuk ka as ambicje, as ligësi, dhe as egoizëm. Në këtë motiv më tepër se diçka konvencionale, të huazuar nga poezia bashkëkohore evropiane apo rumune, kemi pasqyrimin e jetës së tij të pasigurtë dhe të shqetësuar.

*...lark o qytet prej meje
dua liri
se shije s'kam parë prej teje
as bukuri.*

Ka çaste kur Asdreni e idealizon jetën patriarkale të fshatit, të bujqëve dhe të barinjve («Të korrat», «Bariu», «Prendvera», «Ardhje prendverës», «Mbrëmanet në fshat» etj.), por nuk do të ishte e drejtë që në këtë gjë të shihnin synimin e poetit për të fshehur gjendjen e vërtetë sociale të fshatit shqiptar në atë kohë. Poetizimi i jetës së fshatarve lidhej jo me bindjet politiko-shoqërore të poetit, se sa me detyrën artistike që ai i vuri vetes në këto krijime. Asdreni i këndoi jetës së thjeshtë të fshatarit, lartësoi ndieniat e tija të pastërta në kontrast me ambicjet, egoizmin dhe individualizmin e njerëzve në qytet.

Në një varg krijimesh të poetit populli na shfaqet si bartës kryesor i vlerave morale. Tek flet për bujkun apo bariun, Asdreni thekson si tipare të përgjithshme kombëtare mirësinë, dashurinë për punën dhe thjeshtësinë në jetë të njerëzve të vegjëlisë. Në themel të kësaj mirësie dhe thjeshtësie qëndron optimizmi i pashtershëm dhe urtia e thellë e popullit. Qëllimi i poetit është të vërë në pah karakterin e mirë të fshatarëve, natyrën e tyre të paprishur prej veseve të shoqërisë borgjeze. Në vjershën «Bariu», që është tipike për këtë kategori krijimesh, Asdreni flet për thjeshtësinë dhe çiltërsinë e jetës së bariut, për të cilin është i huaj vaniteti i njerëzve të qytetit:

*Burimi rrjedh pranë, ay ri edhe ha!
Përmi natyrë mbretëron e përmi botë.
Bukurin' e njuh, ligësi ndë zemër s'ka
E për çdo madhësi ay është i ftohtë.*

Fshati ishte për Asdrenin një mundësi për të shpëtuar nga brengat dhe shqetësimet e jetës sociale të qytetit. Ndonjëherë poeti përpigjet t'i gjejë ngushëllim shpirtit të tij të trazuar deri në fund, duke u strehuar në kohën e shkujdesur të feminisë së vet. Por as arratisja në jetën idilike patriarkale të fshatit, as prehja në kujtimet e viteve të rinisë dhe as arratisja në gjirin e natyrës, nuk e shpëtojnë poetin nga realiteti i shoqërisë borgjeze me doket dhe moralin e saj të xhunglës. Duke mos qenë në gjendje të luftojë kundër së keqes shoqërore, poeti arrin në konkluzionin se njeriu nuk ka mundësi të bëhet i lumtur në shoqërinë e kohës, se në botë ka vetëm vaj e lot.

*Ah, lumtësi! Sa her' s'të kam kërkuar
Si rrezet njej mëngjezi të shëndritur,
Si dritën e një syri të kulluar!
S'di vallë vendi i yt ku munt të jetë?*

Ishte kjo klithma e një shpirti të ndershëm e të etur për një grimë lumtëri, e një shpirti që jeta i kishte caktuar dhëmbje e brenga, e një shpirti që aspironte një shoqëri ku njerëzit të rronin të lumtur, por nuk shihte përreth veç babëzi dhe egoizëm.

Një grusht i rëndë për idealet humane të Asdrenit ishte Lufta e parë botërore. Në ciklin e vjershave që shkroi në ato vite, poeti e dënoi luftën imperialiste si akt shnjëzor, që u sjell popujve mjerime dhe vuajtje të tmerrshme, si stuhi që shkatërron njerëzimin dhe kulturën, si gjakderdhje kriminale. Shigjetat e Asdrenit ishin drejtuar kundër mbretërve, të cilët i stigmatizon për krimet e tyre në kurriz të popujve, për hipokrizinë e tyre të poshtë, për përbuzjen e tyre cinike ndaj atyre, të cilët i çuan në kasaphanën e luftës. Merita e Asdrenit është se nuk e la veten të gënjejhet nga propaganda trullësuese shoviniste e dy kampeve kundërshtare. Por tek demaskon karakterin shnjëzor të luftës, poeti nuk tregon se ç'duhet bërë. E ardhmja e njerëzimit i shfaqet e pashpresë dhe nis e tallet me idenë që dikur pat besuar vetë, sinqerisht, se zhvillimi i dijes do t'i bëjë njerëzit më të përsosur nga pikëpamja morale. Bindja e tij se njerëzimi nuk do ta gjejë rrugën e shpëtimit vinte sepse problemën e luftës dhe të burimeve të tij Asdreni e shikoi në plan moral-abstrakt.

Ngjarjet që pasuan shpalljen e pavarësisë, si shëmbja më 1914 e shtetit të pavarur kombëtar nga intrigat e forcave të brendshme reaksionare të yshtura nga shtetet imperialiste dhe sidomos fakti që sigurimi i pavarësisë dhe i tërësisë tokësore në vitin 1920 nuk solli realizimin e ëndërrave të masave të popullit dhe të patriotëve, ndikuan në mënyrë vendimtare në evolucionin e mëtejshëm të Asdrenit si shkrimtar, përcaktuan të gjithë karakterin e zhvillimit të krijimtarisë së tij poetike.

Asdreni, sikurse shumë patriotë e demokratë të tjerë, pati ushqyer shpresën se sigurimi i pavarësisë kombëtare do të hapte rrugën e përparimit e të lulëzimit të atdheut dhe do të sillte përmirësimin e jetës së veçjëlisë. Por jeta tregoi se kjo ishte vetëm një iluzion. Klasat e larta e shfrytëzuan patriotizmin e masave popullore për interesat e tyre. Postet kryesore në shtetin e ri shqiptar ranë në duart e elementëve antipatriotë

dhe reaksionarë, ish-memurë të perandorisë otomane, shumë prej të cilëve e kishin luftuar më parë lëvizjen kombëtare. Nën sundimin e forcave të vjetra shoqërore idealet për të cilat kishin luftuar disa breza patriotësh u shkelmuan, sakrificat e vegjëlisë u harruan; gjëndja e masave jo vetëm që nuk u përmirësua, por u keqësua. Njerëzit që erdhën në pushtet dhe nisën të drejtojnë fatet e Shqipërisë Asdreni i shikonte si një forcë që nuk e përligjnin veten, nga asnjë pikëpamje, si njerëz pa kurrfarë vlere morale dhe mendore, si një forcë ogurzezë e negative, si anadollakë të krimbur, me botëkuptim dhe dëshira obskurantiste, që nuk ngjallnin veçse neveri. Nga kjo pikëpamje ata s'meritonin veçse të qesëndiseshin me ndonjë thumb. Por ata përfaqësonin në vetëvete një forcë shkatërruese, që po i sillte dëm vendit, duke zhdukur gjithshka që ishte arritur me përpjekjet dhe sakrificat e patriotëve dhe të masave të popullit. Kjo nuk mund të mos i ngjallte poetit dëshirën për t'i fshikulluar pa mëshirë. Kryesisht, poet lirik nga frymëzimi, ai rrëmben në këto çaste kamshikun dhe godet fuqishëm, ashpër, për ta demaskuar deri në fund të keqen. Janë të këtyre viteve një varg krijimesh satirike si «Hymni i festës», «Republika shqiptare», në të cilat gjejmë indinjatën dhe përbuzjen e thellë të poetit për këta njerëz, të cilët, megjithëse e kishin këmbyer festën e kuqe me kapelën dhe bisedojnë plot «ndjenja shqiptarije», në shpirt kanë mbetur anadollakë, sa «bota s'i kuptojnë turq në jan'apo shqiptarë». Asdreni nxori me mjeshtëri në pah thelbin reaksionar e obskurantist të shtetit çifligaro-borgjez, që u ngrit pas dhjetorit të vitit 1924, demaskoi demagogjinë e sundimtarëve dhe zyrtarëve, me anë të së cilës ata orvateshin të mashtronin popullin.

Në veprën tjetër të rëndësishme të fillimit të viteve 20, «Burri i dheut», paraqitet tragjedia e mashtrimit të vegjëlisë, ndjenjat kombëtare të së cilës iu nënshtruan qëllimeve egoiste të klasave sunduese. Në karakterin e heroit të poemës, një djalë i ri fshatar, pjesëmarrës i luftës së Vlorës më 1920, poeti mishëroi cilësitë e popullit, që me gatishmëri e shpirt të lartë vetmohimi iu përgjigj thirrjes për mbrojtjen e atdheut, me shpresë se fitimi i lirisë e i pavarësisë do të zgjidhte hallet e saj të ngutshme. Vërtetë Asdreni nuk zbuloi rrënjët shoqërore të iluzioneve të masave të popullit (sepse vetë ai, nuk i kishte të qarta), por vepra ka rëndësi për frymën e vet demaskuese dhe për faktin se ajo përshkohet nga parandjenja e zgjimit të afërt social të vegjëlisë:

*Jemi bujq e truall s'kemi
Zotërinjtë e mbajnë frerin
... Tërë ditën shpinëthyer
Punë, punë na kërkojnë
Në çdo brazdë të parmendës.
Djersa jonë pa pikuar,
Nga sa korrim një grusht s'kemi.*

Këto fjalë të nënës plakë të martirit përfaqësojnë në vetvete një akuzë të fortë kundër shfrytëzimit të egër feudal. Edhe në vjershën «Fisnikët e Shqipërisë» Asdreni zbuloi fytyrën mizore të bejlerëve, të cilët pasuritë e tyre i kishin grumbulluar me grabitje në kurriz të popullit dhe duke vrarë ata që nuk u nënshtrorëshin.

Nga rezultatet e vajtueshme të përpjekjeve të patriotëve e të masave të popullit dhe forcimi në pushtet i elementëve reaksionarë dhe antipatriotikë, Asdreni u dëshpërua shumë. Kjo situatë jo e favorshme për të

gjithë ata që ishin përpjekur për një shtet të pavarur të qeverisur me ligj, ku mbi të gjitha të qëndronte interesi i përgjithëshëm, përparimi ekonomik-shoqëror e kultural i vendit, peshoi shumë tek Asdreni, sepse vetë ishte një nga patriotët e vërtetë, të cilët u flakën, siç thoshte vetë poeti, si «dhëmballa të prishura». Bejlerët dhe forcat reaksionare nuk ja falën Asdrenit vjershat e forta kundër parisë, që shkroi në vitin 1904-1912. Si hakmarrje ata e nxorën Asdrenin nga vendi modest që zinte në konsullatën shqiptare të Bukureshtit, duke e lënë pa mjete jetese. Megjithëse rrahu për një kohë të gjatë dyertë e administratës shtetërore të atëhershme, Asdreni nuk arriti dot të fitojë të drejtat e veta të rrëmbyera arbitrarisht. Kjo e hidhëroi pa masë Asdrenin, siç shihet edhe nga një letër e tij shkruar në ato vite: «Në vend që të kem pak prehje pas aq vjet, të jem i përkrahur e të rroj duke punuar, qeveritarët e sotshëm të bijen me shqelmë e që t'u bëhet vend gjith atyreve që tërë jetën e tyre kanë rrojtur me mënyra të dyshimta, po të zotërit ta rëmojnë tjetrin si Juda për pak argjend. Çuditë si nuk u gjend një njeri të ngrehë zërin e të thotë dy fjalë të mprojë të drejtën e të vërtetën po të durojë që lajka dhe gënjeshtria të mbretërojnë».

Kjo situatë çoi në shfaqjen e tendencave të reja ideore dhe artistike në krijimtarinë e Asdrenit.

Si reaksion ndaj kësaj gjendje në poezitë e fillimit të viteve 20 nisin e kumbojnë motivet e lodhjes e të pesimizmit. Shpirti i cfilitur i poetit kërkon prehje duke ikur nga bota reale në një botë iluzore të krijuar nga fantazia e tij («Excelsior»), ose të harrohet në tingujt e lirës së vet. («Ora e zemrës»). Fakti, që përpjekjet e patriotëve dhe të masave të popullit nuk dhanë frutet e dëshiruara, i ngjalli Asdrenit dyshime në mundësitë e njeriut për të ndryshuar gjëndjen ekzistuese të sendeve. Poetin nis ta ndjekë ideja se njeriu është një qënje e pafuqishme, e mjerë, vegël në duart e forcave të errëta e të pakuptueshme që veprojnë në jetë. Kjo frymë fataliste gjeti pasqyrim në një varg krijimesh të vëllimit të tij të fundit «Psallme murgu» (1930), si në vjershat «Fjala e Dodonës» (1920), «Kotësia» (1923), «Hija e keqe», «Shih si endet bota», etj. Me këtë është e lidhur ngushtë ideja se njeriu duhet t'i nënshtrohet fatit dhe ta kufizojë veten në dëshirat dhe qëllimet që ka («Hieja e zemrës», «Ballada e bariut»), se jeta është gënjeshtare, në rini ajo premtion shumë shpresa dhe gëzime, por nuk i sjell njeriut veçse pikëllime dhe shgënjime («Fytyrë»).

Në një nga poezitë më karakteristike të kësaj kategorie «Paradokse» jeta e njeriut përshkruhet si lëvizje fatale në «rrethin vicioz» të qënjes, si një pakënaqësi e përjetshme ndaj asaj që njeriu dëshiron dhe bën. Kjo ishte shprehje e një skepticizmi ekstrem. Ideja se përpjekjet e njerëzve për të ndryshuar diçka në rendin ekzistues dhe në gjëndjen ekzistuese të sendeve janë të kota, kalon në konceptin se njeriu është mëkatar dhe se për të gjitha ato që ai heq në këtë botë do të shpërblehet në botën e përtej varrit («Mos humbisni shpresën», «Lutje e vonuar»). Çastet e pesimizmit të zi përftojnë tek poezia e Asdrenit motivin fantastik të metapsikozës, të ekzistencës së dytë të shpirtit të njeriut («Mister», «Dëshirë pagane»).

Megjithëse në «Psallme murgu» motivet e dëshpërimit e të pesimizmit kumbuan me forcë, ato nuk janë të vetmet në krijimtarinë e poetit. Në këtë vëllim u përfshinë edhe shumë krijime poetike në të cilat duket se poeti nuk e humbi përgjithnjë besimin në jetë («Fytyrën tënde», «Barresha», «Letër prej katundit», «Marshi i djalërisë shqiptare», etj.).

Një nga veprat më të shquara të viteve 30 të Asdrenit është poema satirike «Trashgimi». Në këtë vepër, që u hartua më 1935, por që për shkak të frymës së fortë demaskuese mbeti në dorëshkrim, Asdreni shkroi padinë e vet kundër regjimit gjakatar të Zogut; ishte kjo jo padi, por dënim i pamëshirshëm që u dha poeti atyre forcave që shkelmuan idealet e rilindasve dhe e katandisën popullin në një jetë plot varfëri dhe mizerje pa fund:

*Të zbathur e të xhveshur ndër vrima dhe kasolle,
Një lind, pesë vdesin, me kërmat mahin tokën,
Fëmijtë si cirua prej ethesh e prej kolle,
Si fiq të thatë fishkur, mezi e shpien kokën,
Më njanë sheh të ngopur, të ngjallmë, barkalecë,
Dinakë mu si dhelpra, çdo send me grep ta heqin.*

.

*Ushqehen parazitë, pa bërë kurrnjë punë,
Që rrojnë me gënjeshtër, që shesin çdo ndërgjegje;
Me kokën plot me krunde, lëkurën mu si gunë,
Shushunja gjak të thithin, pa dhën' e asnjë përgjegje.*

Kjo dëshmon se aspiratat për drejtësi dhe liri shoqërore, që e kishin frymëzuar dikur në publicistikën dhe krijimtarinë poetike, nuk ishin shuar në vetëdijen e poetit; ato vijonin të mbaheshin gjallë në skutat e shpirtit të shumëvojtur dhe herë pas herë, me forcë të mekur e me ndërprerje çonin lëng jete në dejt e muzës së poetit.

Në krijimet e fundit të Asdrenit ka ndonjë vjershë të gabuar, fryt jo i bindjeve, por i miopisë së tij politike. Por megjithë gjendjen jo të favorshme shoqërore-politike në vitet 20-30, megjithë vetminë, e cila, u bë më e rëndë në këto vite, si edhe brengat e pleqërisë, Asdreni u mbeti besnik idealeve të tij demokratike.

Megjithëse larg në dhé të huaj, Asdreni mëndjen e kishte në atdhe; ai rron me shqetësimet dhe shpresat e reja të vendit. Në zemrën e tij jetonte e gjallë dashuria për vendin. Ishte kjo ndjenjë e madhe dashurie për Shqipërinë, që e shtyri Asdrenin, të përshëndesë diellin e lirisë së vërtetë që agoi në vendin tonë me ngadhënjimin e pushkëve partizane, t'u gëzohet ditëve të lumturisë dhe të begatisë që solli Partia për popullin shqiptar. Është kjo dashuri e sinqertë që e bëri Asdrenin të brohorasë bashkë me masat e çliruara nga vargonjt e robërisë:

*Sot mori fund çdo gjurmë tiranie,
Një djell' i ri po ndrit plot me shkëlqim,
Për kombin lind një kohë lumtërie
Edhe për bishat e egra një shkatrim.*

* * *

Asdreni zë një vend të shquar në historinë e letërsisë shqiptare. Ai është poeti që sa i rrekëtiu zemra mendoi dhe aspiroi për një Shqipëri të lirë e të pavarur, për një Shqipëri të vegjëlisë, të opingës. Ai bën pjesë në atë falangë patriotësh dhe demokratësh, që u përpoqën për ta nxjerrë kombin nga «errësira mesjetare-feudale, imperialiste në dritë, në kryengritje, në luftë, për liri, pavarësi, demokraci».

R é s u m é

LE POÈTE ASDREN ET SON TEMPS

Cet article constitue une tentative à analyser d'une façon synthétique le rapport d'Asdren — poète à l'époque dans laquelle il a vécu et a agi.

Considérant, dans ses lignes générales, le contenu conceptuel de l'oeuvre du poète, l'auteur fait constater que Asdren est l'un du petit nombre d'auteurs albanais qui ait senti aussi profondément le pouls de l'époque, en traitant les questions criantes soulevées à différentes époques devant le mouvement de libération du peuple albanais.

Tout d'abord l'auteur fait une mise en place de l'attitude du poète envers la lutte de libération nationale du joug ottoman. Une partie considérable des productions poétiques d'Asdren est empreinté par les idées patriotiques, qui font surgir à l'esprit de ses compatriotes le sentiment de la conscience nationale, les invitent à s'unir et s'organiser pour recouvrer la liberté et l'indépendance nationale.

C'est dans ce cadre que Asdren comprend bien vite que dans les rangs du mouvement patriotique avait commencé le processus de la différenciation. Les classes de la société albanaise de ce temps envisageaient de façon différente, en concordance avec leurs intérêts de classe, le but final de la lutte contre le joug étranger ottoman.

Les masses laborieuses cherchaient à satisfaire, dans le même temps que la disparition de la botte étrangère, aussi leurs aspirations sociales. Asdren, qui fait état d'un tempérament citadin poussé, défend instamment les intérêts du petit peuple contre l'oppression inhumaine des beys et en général des couches antipatriotiques. Dans plusieurs de ses productions trouve son reflet le conflit entre les combattants de la liberté, provenant du petit peuple, et les classes nanties, la féodalité et la bourgeoisie conservatrice.

Asdren est synthétisé aussi comme poète, dans cet article, un poète qui a reflété dans son oeuvre les vicissitudes spirituelles de l'homme du commun soumis à l'ordre bourgeois, où l'objet de toute activité est l'argent.

Une grande place est accordée, toujours dans notre article que nous résumons, à l'analyse du contenu de la production des années 20-30. L'auteur considère que ces créations font d'Asdren un des auteurs les plus complexes de l'histoire des lettres albanaises, ce qui est déterminé par les circonstances sociale et politiques qui ont laissé leur empreinte à la plus grande partie de sa vie et de son activité. Les résultats déplorables des efforts des patriotes et des masses populaire albanaises, dont le sacrifice est devenu l'objet d'appropriation de la part des hautes classes réactionnaires, le déclin du mouvement démocratique, uni à son isolement et aux chagrins de vieillesse, ont fait que dans la création de cette période du poète soient soulignés les motifs de pessimisme et de lassitude. Asdren s'égare et perd la perspective de la vie sociale dans les années 20-30. L'insuffisance de clarté à comprendre les tendances du développement historique unie à son isolement ont fait que le poète passe une forte crise dans son âme.

Pourtant, malgré toutes ces manifestations qui rejoignent le versatile, Asdren a une place éminente dans l'histoire des lettres albanaises. Il est le poète au coeur chagriné, qui a pensé et a aspiré pour une Albanie libre et indépendante, pour une Albanie du petit peuple. Il fait partie de cette phalange de patriotes et de démocrates qui ont mis tout leur effort à faire tirer à la nation des ténèbres médiévales, féodales et impérialistes, et la porter à la lumière, à l'insurrection, à la lutte pour la liberté, l'indépendance, la démocratie.

